



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 250, datë 20.12.2022

PËR
REGJISTRIMIN E AKTOFERTËS SË EMETUESIT, SHOQËRIA "BANKA CREDINS"
SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të pikës 22, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, nenit 248, pika 4, e Ligjit nr. 62, datë 14.05.2020 "Për Tregjet e Kapitalit" si dhe të Rregullores nr. 187, datë 16.12.2020 "Për formën dhe procedurën e regjistrimit të aktofertës për emetimin e obligacioneve", Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

VENDOSI:

1. Regjistrimin e aktofertës së emetuesit, shoqëria "Banka Credins" sh.a., për emetimin e obligacioneve të nënrenditura (borxh i varur) të konvertueshme në aksione të zakonshme me afat 7 vjet, me normë interesi fikse, për shumën 300,000,000 Lekë dhe 8,000,000 Euro.
2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Titujve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU



DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU



V2022053950854275709

DATE 28/12/2022
NR REP 12142

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN

Sot, më datë 28/12/2022, para meje Noterit JULIAN ZHELEGU, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

KËRKUES/IT:

Griselda Çakalli, atësia Xhelal, amësia Hatixhe, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane dhe banues në TIRANË, me adresë Myslym Shyri; Nd. 8; H. 27; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 31/10/1991, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036525564 dhe nr. personal J16031049B,

e cila me kerkoi te vertetoj dokumentin e njejte me origjinalin Vendim nr. 250 date 20.12.2022.

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

JULIAN ZHELEGU





Datë 17.11.2022

VENDIM
NR. 5/2 DT. 17.11.2022
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË SHOQERISË "BANKA CREDINS " SH.A.

Sot, me datë 17.11.2022, në orën 11:00, në selinë e shoqërisë me adresë në Rr. "Vaso Pasha" Nr.8, Tirana, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë BANKA CREDINS SH.A., shoqëri anonime shqiptare, regjistruar në mënyrë të rregullt në Regjistrin Tregtar, me Vendim Nr. 28969, të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë, datë 31.01.2003 (referuar më poshtë si "Shoqëria").

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme iu njoftua të gjithë aksionerëve, në mënyrë të rregullt në respekt të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të Shoqërisë, me datën 27.10.2022, me anë të postës së Bankës dhe po atë datë u publikua edhe në faqen e bankës në internet www.bankacredins.com. Njoftimi u shoqërua në mënyrë të rregullt nga dokumentacioni përkatës i mbledhjes.

Ishin të përfaqësuar në Mbledhje 58.41% e Kapitalit të Shoqërisë, e vërtetuar nga Lista e Pjesëmarrjes, e cila u nënshkrua nga të gjithë të pranishmit. Si konkluzion, Kuorumi i nenit 144 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me më shumë se 50% të kapitalit, është përmbushur. Mbledhja merr vendime me $\frac{3}{4}$ e aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Mbledhja e Asamblesë u drejtua nga z.Maltin Korkuti. Sekretar i Mbledhjes u caktua znj. Dora Vako.

Rendi i dites:

1. Propozim për miratimin e emetimit të ri të obligacioneve afatgjate të konvertueshme në aksione të zakonshme të Bankes Credins sh.a.

Asambleja e Përgjithshme pasi konfirmoi kompetencën e saj për të vendosur, duke u bazuar në Ligjin Nr 9662, datë 18.12.2006 " Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe në Statutin e shoqërisë, në formën e vendimit:

VENDOSI

1. Te miratoje emetimin e ri të obligacioneve afatgjate të konvertueshme në aksione të zakonshme të Bankes Credins:

- a. Vlera totale e emetimit do të jetë 300,000,000 Leke dhe 8,000,000 Euro.
- b. Vlera nominale e cdo Obligacioni: 1,000,000 Leke, 10,000 Euro.
- c. Shuma minimale e nënshkrimit për çdo investitor është 6,000,000 (gjashtëmilion) Lekë; 50,000 (pesëdhjetëmijë) EUR
- d. Obligacionet e emetuara nuk do të jenë të garantuara nga asnjë mjet sigurimi apo garancie nga Emetuesi apo persona të tretë.
- e. Obligacionet e Bankes Credins do emetohen me "par value", me cmimin që i korrespondon vleres nominale të cdo prerje obligacioni. Kjo do të thotë që çmimi i blerjes së tyre është i barabartë me 100% të vlerës nominale. Shumat e obligacioneve janë me prerje minimale në 10,000 (dhjetë mijë) euro dhe 1,000,000 (një milion) Leke.

Oferta e obligacioneve u drejtohet vetëm klientëve që blejnë obligacione me një vlerë prej të paktën 6 000 000 lekë, 50 000 euro për klient, për çdo ofertë veçmas;

- f. Raporti i konvertimit përcakton numrin e aksioneve që përfitohen nga konvertimi i secilit obligacion. Konvertimi i shumës së obligacioneve në aksione bëhet bazuar në cmimin e aksionit.

Nr. Aksionit = Vlera obligacionit/Cmimin e aksionit

- g. Çmimi i aksionit është vlera kontabel (book value) për aksion që rezulton, në kohën kur bëhet kërkesa për konvertim nga palet, sipas pasqyrave financiare të 3 mujor-it me të fundit, të publikuara.
E drejta e konvertimit në aksione mund të ushtrohet nga zoteruesi i obligacioneve për të gjithë vlerën ose një pjesë të Obligacioneve të Konvertueshme në aksione të zakonshme, por në asnjë rast kjo vlerë nuk është më e vogël se vlera nominale e përcaktuar për një obligacion. E drejta e konvertimit në aksione mund të ushtrohet nepermjet paraqitjes së kërkesës së konvertimit të Obligacioneve të Konvertueshme në aksione të zakonshme (në vijim "Kërkesa e Konvertimit"), pranë Bankes Credins Sh.a. Kërkesa e Konvertimit duhet të paraqitet në çfarëdo dite pune. Banka Credins ka të drejtën e miratimit ose jo të konvertimit të obligacioneve në aksione të zakonshme. Në rast të dhenies së miratimit nga ana e Bankes, të konvertimit të obligacioneve në aksione të zakonshme, kjo e fundit përgatit kontratën përkatëse.
Banka gezon të drejtën t'u kërkojë në cdo kohë, përgjate periudhës së kohezgjatjes së obligacionit, me shkrim, zoteruesve të obligacioneve, konvertimin e pjesshem apo të plote të obligacioneve të nënshkruara dhe të paguara, në aksione të zakonshme. Në rast të konfirmimit për pranimin e kërkesës nga zoteruesi i obligacioneve, banka përgatit kontratën përkatëse.
- h. Fondet nga Emetimi i obligacioneve të konvertueshme në aksione të zakonshme do të përdoren nga Emetuesi për plotësimin e kapitalit të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve. Fondet e mbledhura nga emetimi i obligacioneve të konvertuara, do të përdoren gjithashtu nga Emetuesi në aktivitetin bankar, i cili konsiston në dhënie e kredive të formave të ndryshme si edhe në investime karakteristike të këtij aktiviteti.
- i. Vlera e kapitalit të Bankës të nënshkruar, të paguar dhe të regjistruar në QKB më 31.10. 2022 është 11.503.786.441,55 leke. Emetimi i ri i obligacioneve në total zë 0.42% të kapitalit aksionar të nënshkruar dhe regjistruar.
- j. Shlyerja e kapitalit dhe pagesa e interesave garantohen vetëm nga kapitali i emetuesit. Titujt nuk përmbajnë asnjë garanci reale apo personale të personave të tretë dhe nuk

janë të lidhur me fondin e garancisë së depozitave në mbrojtje të depozituesve nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

k. Struktura e emetimit dhe numri i obligacioneve:

Emertimi i Obligacionit të konvertueshme në aksione të zakonshme	OBLIGACION AFATGJATE ME NORME INTERESI FIKSE (BORXH I VARUR)- TË KONVERTUESHME NË AKSIONE TË ZAKONSHME
Kohezgjatja	7 vjet
Cmimi i Emetimit	100% e vlerës nominale
Frekuenca e kuponit	Gjashtëmujore
Perqindja e Kuponit	Në LEK, 7Y, norme fikse, 8.00%; Në EUR, 7Y, norme fikse, 5.00%;
Rimbursimi	100% Vlerës Nominale në maturim
Garanci për Obligacionin të konvertueshme në aksione të zakonshme	Nuk është e parashikuar
Shlyerje fakultative, përpara afatit të maturimit, nga emetuesi	Shlyerja e obligacioneve përpara afatit nga ana e emetuesit do të bëhet konform rregulloreve të Bankës së Shqipërisë, si dhe përcaktimeve në kontratën e titujve.
Transferueshmëria	Po
Pranimi për tregtim në treg të rregulluar, PSHT, POT	Kjo është ofertë private. Emetuesi synon që Obligacionet të tregtohen në një Platformë Shumëpalëshe Tregtimi apo Platformë të Organizuar të Tregtimit (POT), të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

2. Ngarkohet Drejtoria:

- të kryejë regjistrimin e Vendimit të Emetimit të Obligacioneve në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- të ndjekë procedurat ligjore për marrjen e miratimit të regjistrimit të Akt-Ofertës në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare sipas Ligjit nr. 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit" dhe për marrjen e miratimit paraprak nga Banka e Shqipërisë, të nënshkruajë kontratat dhe cdo dokumentacion tjetër lidhur me emetimin e obligacioneve të sipërpërmendur në pikën 1.

AKSIONARËT E SHOQËRISË

Aleksandër PILO

Emi SANTO

B.F.S.E Holding BV
përfaqësuar nga Sekol Nako

Neritan DOJAKA

Renis TËRSHANA

Alba THOMOLLARI

Unioni Shqiptar Kursim Kredie
përfaqësuar nga

Artur AGOLLI

Monika MILO

Astrit HANA

Fuad HAXHIYMERI

Jorgjia BALLI

Xhejms ALIZOTI

Leonat KOCO

Veneranda BUSHATI

Edmond REXHO

Maltin KORKUTI

Elena HAXHIYMERI

Aida BUSHATI

Elisabeta HYSI

Bardhi HOXHA

Pandeli GARO

Egi SANTO

A.F.C sh.p.k
përfaqësuar nga Shpend Sejdarasi

Vjollca BUSHATI

Albens BUSHATI

Piro MILO

Mirela NDINI

EDRO sh.p.k
përfaqësuar nga Edmond Rexho

Edita HOXHA

PRIMA SHPK
përfaqësuar nga

Hajrulla KALO

Dritan TODHE

Edmond HOXHA

Robert LUKAJ

Suela HOXHA

Keti XHAMO

Kujtim SPAHIU

Shefki DOMA

Petrit KASAPI

Tefik KOKONA

Andon DAKA

Arjan HANA

Anyla KASNECI

Helidon KOKONA

Lorenc BEJKO

Fatmira DINA

Mira MEKSI

Elvira BABOCI

Gjergj BUSHATI

Gëzim BALLA

Xhemal KLOSI

Ardit DUMA

Ashim DOMA





Tonin BINOSHAJ

FRIGO ALBA
Përfaqësuar nga

Ikbalë PAVLLO

Petraq PAVLLO

Kristina PILO

Arian KARROÇI

Shpetim EMIRI

Asllan TROKSI

Zhuljen VARFAJ

Nareda THANASI

Elsa ZHEGA

Lefter SALLATA

Fatjon MAHMUDAJ

Qazim LUFTA

Genc MYFTIU

SHAGA shpk

ARMAAR GROUP
Përfaqësuar nga

Brunilda ALIZOTI

Riçard ALIZOTI

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU**



V2022053950854154452

**DATE 28/12/2022
NR REP 12141**

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGJINALIN

Sot, më datë 28/12/2022, para meje Noterit JULIAN ZHELEGU, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

KËRKUES/IT:

Griselda Çakalli, atësia Xhelal, amësia Hatixhe, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane dhe banues në TIRANË, me adresë Myslym Shyri; Nd. 8; H. 27; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 31/10/1991, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036525564 dhe nr. personal J16031049B,

e cila me kerkoi te vertetoj dokumentin e njejte me origjinalin Vendim Nr. 5/6 date 17.11.2022 i asamblese se Pergjithshme te shoqerise Banka Credins Sh.a.

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

JULIAN ZHELEGU



SHOQËRIA TREGTARE
"A.F.C." SH.P.K

Datë 17.11.2022

VENDIM I ORTAKUT TE VETEM TË SHOQËRISË

"A.F.C." SH.P.K

Sot, më datë 17.11.2022, në Seline e Shoqërise, në Tiranë, Njesia Bashkiake Nr. 2, Rruga Themistokli Gërmenji, Nr. 2, Objekti Nr. 173, Ortaku i Vetem i shoqërisë tregtare "A.F.C." Sh.p.k., e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me Vendimin nr. 1007, datë 26.01.1994, me NUIS J61824006C, vendosi si më poshtë:

Autorizohet Z. Shpendi Sejdarasi të marrë pjesë në mbledhjen e aksionareve të "Banka Credins" sh.a, që do të organizohet me datë 15.09.2022, për të nënshkruar listpresencën, vendimin e Asamblese dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm në këtë mbledhje me rend dite si më poshtë:

1. Propozim për marrjen në pronësi të kolateraleve të debitorëve të Bankës Credins si rezultat i procesit përmbartimor.
2. Propozim për miratimin e emetimit të ri të obligacioneve afatgjate të konvertueshme në aksione të zakonshme të Bankës Credins sh.a.
3. Propozim për miratimin e ndryshimeve në Statutin e Banka Credins sh.a.
4. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionareve të Shoqërisë Credins Invest sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive me rend dite si më poshtë:
 1. Mbi miratimin e riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë "Credins Invest" sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve, për periudhën 3-vjeçare nga data 22.01.2023 deri në datën 22.01.2026.
 2. Mbi miratimin e projektit të ri të fondit të pensionit
 3. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.
5. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "Sea Land Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, me rend dite sa më poshtë:
 1. Mbi miratimin e zmadhimit të kapitalit akionar të "Sea Land Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK
 2. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.
6. Ngarkohet Drejtoria të bëjë njoftimet dhe regjistrimet përkatëse në përputhje me Ligjin.

ORTAKU I SHOQËRISË

Shpendi SEJDARASI

